

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedurës: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me objekt: “Blerje automjeti për nevojat e shoqërisë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT:

Kodi CPV (CPV): **34100000-8**

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 750 000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë: 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Rajoni Elbasan sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetë-deklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriterëve të Përgjithshme të Pranimi/Kualifikim.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë, jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitet 2021 dhe 2022 (Në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të paraqitet vërtetim për shlyerjen e taksës vendore për secilin operator).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, në VKM nr. 922 datë 29. 12. 2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, në VKM nr. 922 datë 29. 12. 2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një nga dokumentat e mëposhtëme:

Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë katalog teknik të mallit, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar. Në katalogë duhet të markohen (për lehtësi identifikimi) specifikimet teknike, të përcaktuara në Shtojcën 5 të DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, germa b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Katalogu i shërben autoritetit kontraktor për të bërë një vlerësim sa më korrekt dhe të saktë të mallrave që do të prokurohen, që të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e autoveturës objekt i prokurimit, gjatë periudhës së garancisë, në servisën e tij ose një servisi të marrë me qira.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar, pasi kjo është një procedurë shumë specifike, ku garancia për këto automjete është e planifikuar minimumi për pesë vite dhe gjatë periudhës së garancisë duhet të garantohet edhe pjesa e kryerjes së shërbimit të servisit në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë. Të gjitha riparimet dhe shërbimet do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues (brenda periudhës së garancisë), e cila kërkon mjedis të përshtatshëm për kryerjen e shërbimeve të riparimit brenda periudhës së garancisë dhe profesionalizëm në kryerjen e këtij shërbimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara ku të përcaktohet garancia dhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të garantojnë që shoqëria prodhuese/distributori i autorizuar do të garantojë se do të furnizojë me të gjitha produktet sipas specifikimeve teknike si dhe për të garantuar mbulimin e periudhës së garancisë nga prodhuesi/distributori i autorizuar, pasi të gjitha atributet ose do të ketë prodhuesi ose në rastin e paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar i kalojnë këtij të fundit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të deklarojë se merr përsipër mbulimin e të gjitha shpenzimeve që mund të lindin si rrjedhim i defekteve të fshehura dhe të paparashikuara që mund të ketë malli objekt prokurimi dhe që nuk kanë ardhur si pasojë e veprimeve të shoferëve të Autoritetit Kontraktor apo nga persona të tretë gjatë periudhës së garancisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kjo pikë garanton AK për të gjithë periudhën e garancisë, që në rastet e defekteve të paparashikuara, që malli objekt i këtij prokurimi të mbulohet nga OE, si autoritet përgjegjës i riparimit të defekteve të mundshme si pasojë e faktorëve të fshehtë teknikë.

2.3.6 Deklaratë e operatorit ekonomik që merr përsipër servisën e mallit objekt prokurimi me pjesë origjinale duke siguruar edhe transportin e automjetit të defektuar me anë të karrotrecit për periudhën e garancisë së mjetit. Karrotreci të jetë në pronësi të subjektit e vërtetuar me certifikatën e pronësië ose me qera e vërtetuar nga kontrata e qerasë e përpiluar përpara noterit gjatë periudhës së garancisë, përfshirë dokumentacionin e rregullt (leje qarkullimi të vlefshme, siguracion të vlefshëm, taksë të paguara dhe kolaudim mjeti të vlefshëm)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12. 2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë këtij kriteri, AK merr garancitë e nevojshme në lidhje me mallin objekt prokurimi, për transportin e mjetit në raste të mundshme defektesh, dhe shërbimet apo pjesët e këmbimit që kanë nevojë të ndërrohen për shkaqet e sipërpërmendura, të jenë origjinale dhe të garantuara.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik

Specifikimet teknike janë hartuar në terma funksionalë sipas funksionalitetit që do të ketë në përdorim automjeti, duke u mbështetur në kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e mallrave që prokurohen, duke i përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë sipas objektit të prokurimit, të cilat krijojnë kushte për konkurrim të paanshëm dhe të hapur për të gjithë operatorët ekonomik, duke mundësuar një trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e interesuar. Këto specifikime teknike janë hartuar në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e konkurrencës dhe trajtim të barabartë nga marka të ndryshme të prodhimit të automjeteve për të gjithë Operatorët Ekonomikë e interesuar.

Njësia e Prokurimit